# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-464211**
VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “Lutem të jem prezente në jetën e saj”, Anjeza Sanço tregon si ja rrëfeu vajzës 6 vjeçare të vërtetën e birësimit |
| ADRESA | `https://piranjat.al/showbiz/lutem-te-jem-prezente-ne-jeten-e-saj-anjeza-sanco-tregon-si-ja-rrefeu-va-i105721` |
| BURIMI | piranjat.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 23 shtator 2026, 20:18:56 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 23 shtator 2026, 20:17:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `f0b2df51e3f9f6824311ef13a46ef84cdbf5b203009e169708bde4bfc3d4ac9c` |
| TEKSTI | `09006ad14f73f49a7e2d928a5d3a5594a23a0ffb8182ac0ae670c1b08c621729` |
| PAMJA | `19dc701d11afb7ab524b54fda6881e62ca55a3f8bc667087e61bfc44d1af9ac2` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `f497e010f7f0aded48f3cb08788cbf10023a2db1938ad35889a5de7f3fc5b9a4` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `55f810520a93a3fb0649992dafdc0630325acd6490d1af12697ee3ba7602edf3` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/f497e010f7f0aded48f3cb08788cbf10023a2db1938ad35889a5de7f3fc5b9a4`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

SHOWBIZ

# “Lutem të jem prezente në jetën e saj”, Anjeza Sanço tregon si ja rrëfeu vajzës 6 vjeçare të vërtetën e birësimit

Piranjat Përditësimi i fundit 23 Shtator 2026, 22:17



Birësimi është një nga historitë më të forta të dashurisë dhe familjes, një rrugëtim që nis me dëshirën për t’i dhënë një fëmije jo vetëm një shtëpi, por edhe sigurinë, përkujdesjen dhe dashurinë që meriton. Influencerja Anjeza Sanço, pohoi se vendimi për të birësuar vajzën e saj ka qenë një vendim i mirëmenduar, me dëshirën dhe njohjen e plotë të saj, duke bërë të mundur që, përmes një procesi të gjatë, ajo të arrinte të birësonte një vajzë 13-muajshe.

Anjeza u shpreh se, me anë të këshillës së psikologes, ajo ia ka treguar të vërtetën vajzës, tashmë 6-vjeçare, me hapa të vegjël dhe në formën e një përralle.

“Unë i kam treguar gjithçka. Psikologia jonë na këshilloi që t’ja tregojmë në një formë përralle sipas moshës. Vajzën unë e mësova që në fillim me një histori përralle, që prej lindjes ajo ka vajtur në një shtëpi tjetër, në ‘shtëpinë e zanave’, për të krahasuar ‘Shtëpinë e Foshnjes’.

Më pas i kam thënë që unë me babin të pamë në ëndërr dhe pamë që ne kishim një fëmijë diku. Kërkuam në male dhe kodra dhe arritëm tek ‘shtëpia e zanës’, kur u hap dera ti vrapove drejt nesh… Ne të pamë dhe që në atë moment ne e dinim që ti ishe fëmija ynë.”

Ajo tregoi se, me rritjen e vajzës së saj, historia e “përrallës ka ndryshuar”, duke shtuar elementë më të vërtetë dhe duke u kthyer kështu në një “tregim”.

“Gjithmonë duhet të shtosh elementë derisa ajo të fillojë të rritet. Kur pa shoqen time shtatzënë, në një bisedë ajo e pyeti se çfarë kishte tek barku dhe mori si përgjigje se gjithë fëmijët rriten tek barku i mamit.

Ajo u përgjigj se nuk ishte e vërtetë pasi ajo kishte lindur tek shtëpia e zanave dhe në këtë moment i shpjegova se ‘unë doja shumë një fëmijë por barku im ishte sëmurë dhe unë lutesha përditë që të vinte një fëmijë në barkun tim, po duke qenë se barku im ishte sëmurë, Zoti e dëgjoi lutjen time dhe të çoi në një bark tjetër. Pas lindjes unë dhe babai u bashkuam me ty te shtëpia e zanave’. Pra ndryshon përralla rrugës sipas moshës, por edhe sipas problematikave që lindin rrugës.”

Sanço u përlot teksa rrëfeu se pasiguritë e së ardhmes e mundojnë, teksa mund të njohë nënën e saj biologjike dhe lutet të jetë prezente në jetën e saj.

“Vajza nuk është prona ime, por është një njeri që ekziston në këtë botë. Ajo ka ardhur në këtë botë dhe do iki kur ta ketë ajo kohën e saj. Unë jam shoqëruesja e saj në këtë jetë. E vetmja gjë që unë lutem është që unë të jem prezente në jetën e saj. Dy vitet e kaluara kanë qenë shumë të vështira sepse kam luftuar me sfidën ‘a do jem unë në jetën e saj kur ajo do të përballet me nënën biologjike dhe me problemet që do t’i vijnë nga shoqëria?’”

Ajo pohoi se vendimin e saj për ta bërë publik birësimin e vajzës së saj e mori duke dashur kështu të bëhej një influencere për birësimin.

“Kjo qasje nuk ishte për t’u bërë e famshme, por duke qenë se unë nisa procesin e birësimit, komente që dukeshin si mbështetëse ndaj meje, por realisht, të para pak nga brenda, lëndonin. Sepse nëse do lëndonin mua, do lëndonin komunitetin dhe fëmijën më vonë. Komenti ‘sa mirë do birësosh dhe do bësh fëmijën tënd’, është një koment që duket si mbështetës, por ajo që bën është krijimi i hendekut brenda vetë njeriut se ‘ai fëmijë që unë po birësoj nuk është fëmija im’.

## Artikuj te sugjeruar

SHOWBIZ 23 Shtator22:01

**Aktorja turke në Milano Fashion Week/ Hande Erçel vlerësohet nga kritika për veshjen më të rafinuar pas zgjedhjes së fustanit të bardhë**

Aktorja e njohur turke Hande Erçel ka tërhequr vëmendjen mes të ftuarve në një prej eventeve prestigjioze të modës n&e...

SHOWBIZ 23 Shtator21:46

**“Mora fjalë” zhduket nga YouTube, Naim Gjoshi ndërmerr hapin e radhës për këngën ikonike**

Një zhvillim i ri ka rikthyer në vëmendje debatin e gjatë rreth këngës “Mora fjalë”, një prej krijimeve m&eu...

SHOWBIZ 23 Shtator18:51

**“E kritikova për Eurovisionin”, shokon Arta Bajrami: Sa të jetë Elhaida, nuk më pranohet kënga në Festival**

Një rrëfim i papritur i këngëtares Arta Bajrami ka rikthyer në vëmendje një episod të vjetër mes saj dhe Elhaida Da...

SHOWBIZ 23 Shtator16:14

**Skandali me lëndët narkotike në Turqi, shoqërohet në polici aktorja e njohur**

Aktorja e njohur turke Afra Saraçoğlu është shoqëruar nga forcat e xhandarmërisë në aeroportin e Stambollit, menjëher&...

SHOWBIZ 23 Shtator16:04

**A do hynte në “Big Brother VIP”? Gazetarja: Qaj shumë, kam nevojë për prindërit**

Gazetarja Trevisa Tufa, ka qenë e ftuar në emisionin “Live From Tirana” me Stenaldo Mëhillin, ku ka folur për karrierën e s...

SHOWBIZ 23 Shtator15:09

**E mbani mend Hazall nga Fate të Kryqëzuara? Aktorja shkëlqen në tapetin e kuq me barkun e rrumbullakosur krah bashkëshortit**

Shumë prej jush e mbajnë mend si Hazallin, vajzën rebele të telenovelës “Fate të Kryqëzuara”, rol që e b&e...

SHOWBIZ 23 Shtator14:03

**Ish-banorja e “BBV4” surprizon me flokët e shkurtër**

Ish-banorja e “Big Brother VIP Albania 4”, Amber, ka surprizuar ndjekësit e saj në Instagram me një ndryshim të dukshëm n...

SHOWBIZ 23 Shtator09:29

**Tom Cruise sfidon AI-n në Hollywood: Kreativiteti njerëzor nuk zëvendësohet**

Në një kohë kur inteligjenca artificiale po hyn gjithnjë e më shumë në Hollywood, Tom Cruise zgjodhi të flasë p&e...

SHOWBIZ 23 Shtator09:22

**Calvin Harris thyen rekordin botëror Guinness/ 1.6 milionë njerëz ndoqën performancën në São Paulo**

Calvin Harris ka hyrë zyrtarisht në librin e Rekordeve Botërore Guinness, pasi vendosi rekordin për audiencën më të madhe n...

SHOWBIZ 23 Shtator08:43

**Jonida Maliqi vazhdon betejën gjyqësore: Nga 3 mijë eurot e sekuestruara te kërkesa për indeksimin e detyrimit ndaj të birit**

Pas procesit gjyqësor të zhvilluar një vit më parë mes Jonida Maliqit dhe Gent Prizrenin, çështjet ligjore mes palëv...

## ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 23 Shtator

**Skandal/ Kreu i SHISH mesazh Agasit: Zemër, duh...**

Më 18 shtator, Vlora Hyseni është marrë në pyetje nga agjentët e Byrosë Kombëtare të Hetimit si person në di...

POLITIKE 22 Shtator

**“Balluku kur do arrestohet?” - Gazetari Qyno: K...**

Gazetari Elton Qyno ka debatuar mbrëmjen e sotme me juristët në emisionin “Top Story”, lidhur me hetimet e SPAK ndaj ish-zëvend&...

AKTUALITET 23 Shtator

**“O shpirt, nesër do takoj Kryeministrin"/ Zbard...**

Komunikimet e zbuluara mes ish-drejtueses së Shërbimit Informativ Shtetëror, Vlora Hyseni, dhe Ergys Agasit zbulojnë një tër&eum...

Nga Xhuljan Ferzaj INVESTIGIME 23 Shtator11:40

[EKSKLUZIVE/ Eskortat e huaja "mbysin" Tiranën: Si vajzat nga Brazili, Kolumbia e Vietnami ofrojnë shërbime sek*uale për 50-150 euro]

Prostitucioni me shtetase të huaja po shfaqet gjithnjë e më hapur në disa prej qyteteve kryesore të Shqipërisë. Përmes...

### video



### PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1





**PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1**




**"Dua 120 mijë euro"/ Si u zaptua prona në rrugën e Durrësit, zbardhet skema e mashtrimit**




Tmerri i 40-vjeçares / Si u shndërrua njohja e re në përndjekje, shantazh dhe denigrim në rrjet

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.